



Pranuar / Dorezuar Primijeno/Prodato Received/Delivery	09.12.2022	viii god veç
Organ /Njesia Organ /Jedinica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix
SKPMESHCK	7865/2022	Sasia Kolicina Quantity 114



Republika e Kosovës
 Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
 NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
 INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.nr.966/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës - Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave i përbërë nga : Arben Mehmeti- kryetar, Malsore Gashi-Bajraktari dhe Eshref Shabani-anëtarë -anëtarë, si dhe Sabile Avdyli- Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtësit, kanë shqyrtuar ankesën A.nr.966/2022, të datës 01.11.2022, së ankueses me adresë banimi Lagjja kundër organit të punësimit Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjis, në çështjen juridike "kompensim material", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, neni 16 paragrafi 3, nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 09.12.2022, mori këtë.

V E N D I M

I. Refuzohet si e pabazuar ankesa me numër A.nr.966/2022, e datës 01.11.2022, e parashtruar nga ankuesja

II. Mbetet në fuqi, Vendimi i datës 19.05.2021, me numër protokolli NR. 2/1K/618, i Zyrës së Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit.

A r s y e t i m

Ankuesja e punësuar në pozitën , Zyrtare e lartë në divizionin për njohje/ barasvlerë dhe informim akademik sipas Akt emërimit të datës 27.08.2020 me nr.ref.4/4-5 në Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës, me datë 01.11.2022, ka parashtruar ankesë me numër protokolli 6598/2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimet ankimore lidhur me kompensimin si pjesëmarrëse në takimin e Komisionit për Verifikimin e

Diplomave të lëshuara nga Universiteti i Mitrovicës së Veriut , i formuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datë 08.11.2022 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë të Ministria e Arsimit, Shkencës ,Teknologjisë dhe Inovacionit ndërsa Këshilli me datë 24.11.2022 ka pranuar përgjigjen në ankesë nga organi i punësimit me numër protokolli 7376/2022 bashkë me shkresat e lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, me qëllim të vërtetimit të plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike dhe bazës juridike, për marrjen e vendimit meritor ka administruar këto prova: Ankesën A.nr.966/2022 të datës 01.11.2022 me numër protokolli 6598/2022 e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Kërkesa për pagesë për punën shtesë e datës 01.07.2020; Vendimi i datës 24.10.2022 me nr.2/1K-2521; Aktgjykimi A.nr.1207/2021i datës 22.09.2022 i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative; Akt emërimi i datës 27.08.2020 ref:4/4-5; Vendimi i datës 13.04.2020 me nr.2-33 i Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Arsimit , Shkencës dhe Teknologjisë; Vendimi me nr.2-738 i datës 15.04.2022; Ankesë e datës 22.04.2021 me nr.ref.618 për Komisionin e Ankesave dhe Parashtresave në Ministrinë e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë; Raporti për muajin maj 2020 mbi verifikimin e diplomave të lëshuara nga Universiteti i Mitrovicës së Veriut; Raporti për muajt prill qershor 2020; Raporti për muajin mars 2020 mbi verifikimin e diplomave të lëshuara nga Mitrovica e Veriut; Kërkesë për pagesë retroaktive e datës 07.10.2020; PAGESA për punën shtesë në Komisionin për verifikimin e diplomave të lëshuara nga Universiteti i Mitrovicës së Veriut e datës 01.07.2020; Lista e pjesëmarrësve në takim e datës 07.04.2020; Procesverbal i takimit të komisionit për verifikimin e diplomave të lëshuara nga Universiteti i Mitrovicës së Veriut i datës 07.04.2020; Procesverbal i takimit të komisionit për verifikimin e diplomave të lëshuara nga Universiteti i Mitrovicës së Veriut i datës 25.06.2020; Lista e pjesëmarrësve në takim e datës 25.06.2020; Lista e pjesëmarrësve në takim e datës 11.08.2020; Lista e pjesëmarrësve në takim e datës 11.11.2020 Lista e pjesëmarrësve në takim e datës 07.04.2020; 20; Lista e pjesëmarrësve në takim e datës 25.06.2020; Lista e pjesëmarrësve në takim e datës 24.01.2020; Vendimi i datës 13.04.2020 me nr.2-33; Vendimi i datës 07.05.2019 me nr.06/102 i Qeverisë së Republikës së Kosovës; Vendimi i datës 08.05.2018 me nr.05/45 i Qeverisë së Republikës së Kosovës; Vendimi i datës 19.05.2021 me nr.2/1K/618; Përgjigje në ankesë e datës 24.11.2022 nga organi i punësimit me numër protokolli 7376/2022bashkë me shkresat e lëndës; Ankesë e datës 22.06.2021 me nr. ref 618 e parashtruar në Komisionin e Ankesave dhe Parashtresave në MASHT; Procesverbal i takimit të komisionit për verifikimin e diplomave të lëshuara nga Universiteti i Mitrovicës së Veriut i datës 11.08.2020; Procesverbal i takimit të komisionit për verifikimin e diplomave të lëshuara nga Universiteti i Mitrovicës së Veriut i datës 11.11.2020 dhe Raport për punën e Komisionit për Verifikimin e Diplomave të lëshuara nga Universiteti i Mitrovicës së Veriut gjatë vitit 2020i datës 28.12.2020 me numër protokolli 3383-18/0016 për Kryeministrin e Republikës së Kosovës;

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, për vendosjen e kësaj çështje, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkangjitura të lëndës, ka konstatuar se ankesa e ankueses është e pa bazuar sepse:

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, gjatë shqyrtimit të pretendimeve ankimore të ankueses, e cila nga organi i punësimit, Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit



,ka kërkuar që ti bëhet kompensimi i mëditjeve për takimet e mbajtura në Komisionin për verifikimin e diplomave të lëshuara nga Universiteti i Mitrovicës së Veriut, bazuar në dispozitat ligjore në fuqi, ka konstatuar se bazuar në shkresat e lëndës si dhe duke marrë për bazë legjislacionin aktual që rregullon këtë çështje, pretendimi ankimor i ankueses është i pa bazuar nga arsyet që do të specifikohen më poshtë.

Bazuar në shkresat e lëndës është konstatuar se ankuesja ka qenë dhe është anëtare e Komisionit për verifikimin e diplomave të lëshuara nga Universiteti i Mitrovicës së Veriut që vërtetohet përmes listës së pjesëmarrjes së anëtareve të Komisionit, në takimet e datës 24.01.2020; 07.04.2020; 25.06.2020; 11.11.2020; 11.08.2020, bazuar në pozitën që mbanë sipas aktemrimit të datës 27.08.2020 me Nr.ref.4/4-5, ankuesja ka marr pjesë si anëtare në cilësinë e Zyrtares së lartë në divizionin për njohje/barasvlerë dhe informim akademik, në Ministrinë e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit gjatë orarit të punës, ndërsa kolegji me rastin e shqyrtimit të kësaj lënde ka konstatuar se bazuar në shkresat e lëndës që kanë ofruar palët në këtë procedurë nuk ka asnjë dëshmi që ankuesja ka kryer punë jashtë orarit të punës e cila mund të konfirmohet me dokumentacion përkatës dhe mbi këtë bazë pretendimi i ankueses për kompensim me rastin e pjesëmarrjes në këto takime është i pabazuar.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave duke analizuar në hollësi vendimin e datës 19.05.2021, me numër protokoll Nr. 2/1K/618, të nxjerr nga Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm në Ministrinë e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, konstaton se ankuesja punën e ka kryer në orarin e rregullt të punës prej orës 08:00 deri 16:00, dhe me qenë se pjesëmarrja në këto takime të Komisionit për verifikimin e diplomave të lëshuara nga Universiteti i Mitrovicës së Veriut nga ankuesja është kryer brenda orarit të rregullt të punës, kolegji konstaton se me qenë se nuk kemi të bëjmë me punë jashtë orarit të rregullt, pretendimi ankimor i ankueses është i pabazuar sepse kjo çështje është e rregulluar edhe me dispozitat e Ligjit Nr.03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civil, si dhe Rregullorja NR. 33/2012 për Shtesat në Pagë dhe Kompensime të tjera të Nëpunësve Civilë.

Kolegji i këshillit bazuar në provat e lëndës, ka konstatuar se pretendimi ankimor i ankueses është i pabazuar, sepse bazuar në dispozitat e nenit 80, të Ligjit Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, përcaktohet se; *"Nëse një punonjës, shërbyes civil ose zyrtar i një autoriteti publik ose organizatë buxhetore, sipas një akti të Qeverisë, kërkohet që të shërbejë në një komision, bord ose organ apo autoritet tjetër publik, ky punonjës, shërbyes civil ose zyrtar nuk ka të drejtë të pranojë, dhe nuk do të pranojë, kurrfarë kompensimi shtesë për këtë shërbim. Shërbimi konsiderohet pjesë e detyrave të obligueshme të postit të cilin e mban punonjësi, shërbyesi civil ose zyrtari i sipër cekur"*, prandaj në këtë kuptim me qenë se kemi të bëjmë me pjesëmarrjen e ankueses në një Komision i cili është formuar me vendimin Nr.05/45 të datës 08.05.2018 të Qeverisë së Republikës së Kosovës, të njëjtës bazuar në dispozitat e Ligjit NR. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë të potencuar si më lartë nuk i takon kompensimi me rastin e pjesëmarrjes së të njëjtës në këto takime, rrjedhimisht pretendimi i ankueses mbi këtë bazë është i pajustificuar dhe paargumentuar me fakte konkrete.

Ndërlidhur me vendimin e datës 19.05.2021, me numër protokoll Nr.2/1K/618, të nxjerr nga Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm në Ministrinë e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, me të cilin vendim, ka refuzuar ankesën e ankueses të datës 22.04.2021 me numër protokoll 618 me arsyetimin, së në bazë të nenit 80, të Ligjit NR. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, nuk i takon kompensim nëpunësit civil, dispozitë të cilën e cituam më lartë, kolegji

konstaton se këshilla juridike në përmbajtje të aktit administrativë të kontestuar është dhënë gabimisht dhe se e njëjta është në kundërshtim me nenin 24 paragrafi 3 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë ku përcaktohet se: "3.Nëpunësi civil ka të drejtë të paraqesë ankesë drejtpërdrejt në KPMSHCK për çdo veprim apo mosveprim, që i cenon të drejtat apo interesat e ligjshme, të drejta këto, që burojnë nga marrëdhënia e Shërbimit Civil sipas këtij ligji", ndërsa sipas nenit 127 paragrafi 3 të Ligjit Nr. 05/L -031 të Procedurës së Përgjithshme Administrative përcaktohet se: "3.Nëse akti administrativ është lëshuar pa informacion, apo me informacion të pamjaftueshëm në lidhje me mjetet juridike administrative (këshillën juridike), afati i parashikuar nga paragrafi 1 i këtij neni, është tre (3) muaj", dhe në këtë kuptim me qenë se ankuesja sipas këshillës juridike ka parashtruar padi në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative e cila me Aktgjykimin A.nr.1207/2021 të datës 22.09.2022 ka aprovuar kërkesëpadinë e paditëses ,ka anuluar vendimin e datës 22.04.2021 dhe lëndën e ka kthyer në rishqyrtim dhe rivendosje te Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit. Ankuesja me datën 27.09.2022 parashtron ankesë në Komisionin për ankesa të Nëpunësve publikë në Ministrinë e Arsimit , Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit i cili Komision me vendimin Nr.2/1K-2521 të datës 24.10.2022 ka refuzuar ankesën e ankueses si të palejuar. Me datën 01.11.2022 ankuesja parashtron ankesën me numër protokolli 6598/2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe nenit 132 paragrafi 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/ Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda, A.nr.966/2022, datë 09/12/2022.

Sabile Avdyli

Sabile Avdyli
Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional,

Arben MEHMETA

Arben Mehmeti
Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dërgohet;

- Ankueses,
- Sekretarit të Përgjithshëm në Ministrinë e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.